

30 DITË *në* AMA

SHQIP ANGLISHT

DËRGO ANKESË PËR RADIO DHE TELEVISIONE



Pg. 1

AMA dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bashkëpunim për promovimin e barazisë dhe luftën kundër diskriminimit



Fq. 1

Krasniqi: Pavarësia e AMA-s matet me indikatorë dhe jo me perceptime. Gjykatat kanë konfirmuar ligjshmërinë e vendimeve tona

DËRGO ANKESË PËR PLATFORMËN X



Fq. 1

Kryetarja e AMA-s takon David Colon, diskutohen sfidat e informacionit në epokën digjitale

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Znj. Armela Krasniqi, zhvilloi një takim me z. David ...

Edukimi mediatik për rreziqet e botës digjitale, takime me gjimnazistët në Tiranë e Durrës

Vijon fushata kombëtare e edukimit mediatik "Kompetencë mediatike për moshat shkollore". Në këtë kuadër, kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi dhe kryetarja e ...



Fq. 1



Fq. 1

Transparenca AMA-TikTok-Platforma X: Rritet numri i përmbajtjeve të dëmshme të hequra nga platforma

Krasniqi: Pavarësia e AMA-s matet me indikatorë dhe jo me perceptime. Gjykatat kanë konfirmuar ligjshmërinë e vendimeve tona

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Znj. Armela Krasniqi raportoi në Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik lidhur me raportin e punës së institucionit për vitin 2025, ku theksoi se "Bordi i AMA-s ka marrë rreth 110 vendime, ndërsa në pesë vitet e fundit janë miratuar mbi 550 vendime, mbi 67% e të cilave me dakordësi unanime".

Në fjalën e saj, Znj. Krasniqi tha se "kjo dëshmon një vendimmarrje të mbështetur në ligj, profesionalizëm dhe me përgjegjësi institucionale". [Lexo më shumë](#)



AMA dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bashkëpunim për promovimin e barazisë dhe luftën kundër diskriminimit

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Znj. Armela Krasniqi, zhvilloi një takim me Komisioneren për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Znj. Genta Tafa Bungo, ku u diskutua mbi forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për promovimin e barazisë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe luftën kundër çdo forme diskriminimi në median audio dhe audiovizive. [Lexo më shumë](#)



Kryetarja e AMA-s takon David Colon, diskutohen sfidat e informacionit në epokën digjitale

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Znj. Armela Krasniqi, zhvilloi një takim me z. David Colon, ekspert në fushën e informacionit dhe komunikimit, ku u diskutua mbi sfidat që po shoqërojnë mjedisin informativ në epokën digjitale. Ata shkëmbyen mendime mbi praktikën europiane dhe sfidat e përbashkëta me të cilat përballen institucionet, mediat dhe shoqëritë demokratike në kushtet e zhvillimeve të shpejta teknologjike.


[Lexo më shumë](#)

Edukimi mediatik për rreziqet e botës digjitale, takime me gjimnazistët në Tiranë e Durrës



Kryetarja e AMA-s, Znj. Armela Krasniqi ishte pjesë e tryezës së mbledhur në Kuvendin e Shqipërisë me temë "Forcimi i kuadrit ligjor të Shqipërisë kundër racizmit dhe gjuhës së urrejtjes: Dialog parlamentar për përafrimin me standardet europiane", e organizuar nga Këshilli i Europës. Kjo tryezë u organizua në kuadër të programit të përbashkët BE/KiE, "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë".

[Lexo më shumë](#)



Transparenca AMA-TikTok-Platforma X: Rritet numri i përmbajtjeve të dëmshme të hequra nga platforma


Gjatë muajit qershor, Autoriteti i Mediave Audiovizive publikoi të dhëna mbi bashkëpunimin me platformën TikTok në kuadër të identifikimit dhe trajtimit të përmbajtjeve të dëmshme, si edhe rasteve të piraterisë së produktit audioviziv shqiptar. Deri në fund të periudhës së raportimit, janë administruar 225 ankesa, nga të cilat 89 janë konstatuar në shkelje të ligjit dhe 65 përmbajtje janë hequr nga platforma. Ndërkohë, për Platformën X, AMA ka administruar gjithsej 70 përmbajtje të raportuara nga publiku, prej të cilave 26 janë identifikuar si shkelje të ligjit.

[Lexo më shumë](#)

Monitorimi i përmbajtjeve gjatë muajit maj: Partitë politike, institucionet shtetërore dhe aktorët dominues në televizionet kombëtare

Të dhënat e monitorimit të përmbajtjeve për muajin maj, të përgatitura nga ekipet e analizës në Autoritetin e Mediave Audiovizive, paraqesin shpërndarjen e kohës së transmetimit për partitë politike, praninë e institucioneve shtetërore dhe aktorët sinkron në televizionet kombëtare. Në monitorimin e partive politike, Partia Demokratike e Shqipërisë zë 73.11% të kohës së transmetuar, e ndjekur nga Partia Socialiste me 25.07% dhe Partia e Lirisë me 0.84%.

[Lexo më shumë](#)



Krasniqi prezanton qasjen për sfidat e epokës digjitale në Konferencën e Liderit Ballkanik

Në Konferencën e Liderit Ballkanik, të organizuar nga Federata Universale e Paqes dhe Iniciativa Ndërkombëtare e Parlamentarëve për Paqe, nën kujdesin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kryetarja e AMA-s ishte pjesë e panelit me temë "Liria e medias, demokracia dhe qeverisja digjitale në Ballkanin Perëndimor".

[Lexo më shumë](#)

